

Harmonizimi i arkitektures te sistemit te arsimit te larte European

**Deklarate e perbashket e kater ministrave te arsimit te larte ne Gjermani, France, Itali dhe Angli me rastin e 800 vjetorit te Universitetit te Parisit.
(Paris, Sorbonne, 25 Maj 1998)**

Kohet e fundit, procesi European ka ndermarre hapa teper te rendesishem perpara. Keto hapa duhet te bejne qe askush te mos harroje se Europa nuk eshte vetem e Euro-s, e bankave dhe ekonomise: ajo duhet te jete nje Europe e dijeve gjithashtu. Ne duhet te forcojme dhe te ndertojme mbi dimensionet intelektuale, kulturore, shoqerore dhe teknike te kontinentit tone. Keto kane marre forme ne nje mase te madhe nga universitet e saj, te cilat vazhdojne te luajne nje rol kyç per zhvillimin e tyre.

Universitetet linden ne Europe, pothuajse para nje treçerek milleniumi. Kater vendet tona po nderojne disa nga universitet me te vjetra qe aktualisht jane duke festuar pervjetoret e tyre, sikunder eshte Universiteti i Parisit. Ne ato kohra, studentet dhe akademiket qarkullonin lirisht dhe perhapnin dijen ne gjithe kontinentin. Ne ditet e sotme, shume nga studentet tane vazhdojne te diplomohen pa patur mundesine e nje periudhe studimi jashte kufijve kombetare

Ne po shkojme drejt nje periudhe ndryshimesh te medha te kushteve ne arsim dhe pune, drejt nje diversiteti te kurseve te karrierave profesionale, kur arsimi dhe trainimi gjate gjithe jetes po shendrohet ne nje detyrim evident. Ne i kemi borxh studenteve tane, dhe shoqerise ne peregjithesi, nje arsim te larte ne te cilin atyre t'u ofrohen mundesite me te mira per te kerkuar dhe gjetur fushen e vertete te shkelqimit te tyre.

Nje fushe e hapur Europiane e te mesuarit ne arsimin e larte permban ne vetvete nje pasuri perspektivash pozitive, sigurisht duke respektuar diversitetet tona, por kerkon nga ana tjetere perpjekje te vazhdueshme per te hequr barrierat dhe per te zhvilluar nje kuader tille te mesuarit dhe mesimdhënies, qe do te gjalleronte levizje dhe bashkepunim me te ngushte.

Njohja nderkombetare dhe potenciali terheqes i sistemeve tona jane te lidhura drejtpersedrejti me njohjet e tyre te brendshme dhe te jashteme. Duket se po lind nje sistem ne te cilin duhet te njihen dy cikle kryesore per krahasim dhe ekuivalence nderkombetare, universitare dhe te diplomuar me grada shkencore.

Pjesa me e madhe e origjinalitetit dhe fleksibilitetit ne kete sistem do te arrihet nepermjet perdorimit te krediteve (te tilla si ne skemen ECTS) dhe semestrave. Kjo do te lejoje vlefshmerine e krediteve te kerkuara per ata qe zgjedhin fillimin dhe vazhdimesine e arsimimit ne universitete te ndryshme te Europes dhe desherojne te jene te afte te marrin grade shkencore ne kohen e duhur te jetes se tyre. Ne te vertete, studentet duhet te jene ne gjendje te futen ne boten akademike, ne çdo kohe te jetes se tyre profesionale dhe nga prejardhje origjine te ndrysheme.

Universitet me grada shkencore duhet te kene mundesi perdorimi te programeve diverse, duke perfshire mundesi per studime shume-disiplinare, zhvillim te aftesive ne gjuhet dhe aftesi ne perdorimin e teknologjive te reja te informacionit.

Ne ciklin e te diplomuarve me grada shkencore duhet te kete zgjedhje ne mes nje grade masteri me te shkurter dhe nje grade doktrate me te gjate, me mundesi transferimi nga njera

tek tjetra. Ne te dyja gradat e diplomimit, theksi i duhur duhet te vihet tek puna kerkimore dhe e pavarur.

Ne dy nivelet, universitare dhe te diplomuar me grada shkencore, studentet duhet te inkurajohen per te harxhuar te pakten nje semester ne universitetet jashte vendit te tyre. Ne te njejten kohe, me shume staf mesimor dhe kerkimor duhet te punoje ne vendet Europiane te ndryshme nga vendi i tyre. Rritja e shpejte e mbeshtetjes te Bashkimit European per levizjen e studenteve dhe mesuesve duhet te shfrytezohet plotesisht.

Shumica e vendeve, jo vetem brenda Europes, jane ndergjegjesuar plotesisht per nevojën e nxitjes se nje evolucioni te tille. Konferencat e rektoreve te Europes, presidente Universiteti, dhe grupe te eksperteve dhe akademikeve ne vendet tona respektive jane perfshire ne studime te gjera ne keto linja.

Nje konvente u aprovua vitin e fundit ne Lisbonë, ne njohje te kualifikimeve ne fushen akademike brenda Europes. Konventa vendosi nje numer kerkesash baze dhe beri te ditur se vende te veçanta mund te perfshiheshin ne nje skeme madje me teper konstruktive. Ne mbeshtetje te ketyre konkluzioneve, çdonjeri mund te ndertoje mbi to dhe shkoje me perpara. Ekziston gjithmone nje baze edhe me e gjere per njohje te perbashket te gradeve shkencore te arsimit te larte per qellime profesionale permes direktivave respektive te Bashkimit European.

Megjithate, qeverite tona, vazhdojne te luajne nje rol te rendesishem ne arrijten e ketyre qellimeve, nepermjet nxitjes se menyrave sipas se cilave mund te percaktohet vlefshmeria e dijeve te perfituara dhe mund te njhen gradet shkencore respektive.

Ne presim qe kjo te nxite marreveshje te metejshtme nder-universitare. Harmonizimi progresiv i struktures se pergjithshme te gradeve dhe cikleve tona shkencore mund te arrihet nepermjet forcimit te eksperiencave ekzistuese, diplomave te perbashketa, iniciativave pilot dhe dialogut me te interesuarit ne kete proces.

Ne kete drejtim, ne angazhohemi te nxisim nje kuader te perbashket refrence, me qellim permiresimin e njohjes se jashteme dhe lehtesimin e levizjes se studenteve ashtu si dhe te mundesive per punesim. Pervjetori i universitetit te Parisit, sot, ketu ne Sorbonne, na ofron nje mundesi solemne per tu pershire ne perpjekjen per te krijuar nje fushe Europiane te arsimit te larte, ku identitetet kombetare dhe interesat e perbashketa mund te bashkeveprojne e te forcojne njera tjetren ne dobi te Europes, te studenteve te saj, dhe me ne pergjithesi te gjithë qytetareve te saj. Ne u bejme thirrje te gjithë Antareve te shtetit te Bashkimit dhe vendeve te tjera Europiane te bashkohen me ne ne kete objektive, ashtu si dhe gjithë Univeriteteve Europiane per te konsoliduar qendrimin e Europes ne bote nepermjet permiresimit te vazhdueshem dhe modernizimit te arsimit per gjithë qytetaret e saj

Translated by: Adriana Bisha
Perkthyer nga: Adriana Bisha

Translation was enabled by SEE ECN.
Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.